

**AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"BALCAN LUXURY MC".**

Në bazë të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) si dhe Ligjet Nr.9273 datë 03.07.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (i ndryshuar);

Sot më datë **15/01/2025**, unë **Franca Forieri**, e ditëlindjes 23/06/1970, lindur në Sanremo, rezidente në Nice, Frence, shtetase italiane, identifikuar me pasaportë italiane me Nr.YB2417033 hartojë këtë AKT THEMELIMI duke shprehur vullnetin tim te lirë si mëposhtë vijonë:

**NENI 1  
LLOJI DHE EMRI SHOQËRISË**

Shoqëria Tregtare e krijuar do të ketë statusin juridik Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar dhe emri i saj tregtar është "BALCAN LUXURY MC". Kjo shoqëri është e themeluar nga Znj. Franca Forieri, një ortake e vetme e cila zotëron 100% të vlerës së kuotave të shoqërisë duke patur rolin e ortakes themeluese të vetme.

**NENI 2  
SELIA E SHOQËRISË**

Zyra Qendrore e shoqërisë tregtare BALCAN LUXURY MC" e ka vendodhjen ne Tiranë, Rrugë "Komuna e Parisit" me zone kadastrale nr. 8260 me nr. Pasurie 6/251-N6.

**NENI 3  
REGJIMI JURIDIK**

Shoqëria është shqiptare dhe me përgjegjësi të kufizuar. Shoqëria "BALCAN LUXURY MC" fiton personalitetin juridik që në momentin që ajo regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit sipas parashikimeve të legjislacionit shqiptar.

**NENI 4  
OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Shoqëria "BALCAN LUXURY MC" do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj tregtare :

- Importimi dhe eksportimi i mallrave me vlerë, veprave te artit, metaleve të çmuara, gurëve të çmueshem te paperpunuara dhe te perpunuar, te bizhuterive materialeve te veshura me metale te cmuara ,diamant, ore, aksesore te ndryshem.
- Këshillues Arti, konsulencë për koleksionistët e artit, blerjet, vlerësimet dhe ekspozitat. Sherbime e vleresime te cilesise se metaleve te çmuar dhe gureve te cmuar.
- Ndërmjetësim ne transaksione luksoze për artikuj/mallra luksoze.
- Agjensi imobilare, blerje, shitje ,dhenie me qera, ndermjetësim per pasuri te paluajtshme dhe kryerja e te gjitha sherbimeve ne lidhje me pasurite e paluajtshme, asistence per regjistrimin e pasurive te paluajtshme prane ASHK, konsulencë ligjore per shitblerje, marketing.
- Shoqeria mund te kryeje cdo veprim apo operacion tjeter qe ka te beje me pronen e paluajtshme, te luajtshme, cdo veprim apo operacion tjeter komercial, industrial e financiar, te dobishern apo plotesues ndaj permbushjes se objektit te Shoqerise.
- Të organizojë trajnime, të importojë dhe të eksportojë mallra dhe shërbime dhe çdo veprimtar, si dhe të kryej çdo aktivitet ekonomik që do të konsiderohet i nevojshëm dhe i dobishëm, në mënyrë që të përbushet qëllimi i veprimtarisë së shoqërisë dhe që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi.

**NENI 5  
KOHËZGJATJA**

Shoqëria "BALCAN LUXURY MC", do të kryej veprimtarinë dhe aktivitetin e saj për një periudhe kohore të papercaktuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çdo lloj shkaku të ligjshëm.

**NENI 6  
KAPITALI I SHOQËRISË**



Kapitali Themeltar i regjistruar i Shoqërisë Tregtare "BALCAN LUXURY MC" përbëhet prej 1.000 (njëmijë) Euro, i përbërë nga 1 kuotë e cila zoterohet 100% nga Ortaku i Vetem i Shoqerise Znj. Franca Forieri.

**NENI 7  
ADMINISTRIMI**

Administrator i Shoqërisë "BALCAN LUXURY MC" i emëruar nga Asambleja e Ortakut të Vetëm është Znj. **Franca Forieri** me një afat 5 vjet me të drejtë rizgjedhje.

**NENI 8  
TË DREJTAT E SHOQËRISË**

Shoqëria ka të drejtë të lidh kontrata dhe të nënshkruaj marrëveshje brenda dhe jashtë vendit. Shoqëria përgjigjet ndaj të tretëve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e derdhur. Shoqëria përballon humbjet vetëm dhe deri në kufirin e vlerës së kontributit të Kapitalit Themeltar.

**NENI 9  
VITI FINANCIAR-EKSPERTËT**

Viti finansiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor perjashtimisht, viti i pare finansiar fillon nga data e regjistrimit të shoqerisë ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe përfundon me 31 Dhjetor.

**NENI 10  
SHPËRNDARJA E FITIMIT**

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit finansiar të cilil i janë zbritur shumat e lena menjane per rezerven sipas ligjit dhe nga ana tjeter jane zbritur ose jane shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e meparshme. Ky fitim i perketh ne masen 100% Ortaku te Vetem te saj.

**NENI 11  
LIKUJDIMI**

Në ketë rast Ortaku i Vetëm marr vendim me shkrim në të cilën parashikojnë mënyren e likujdimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likujdatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likujdatorit dhe emrtesen shtesë "shoqëri në likujdim e sipër. Likujdimi kryhet nga likujduesit e emëruar nga Ortaku i Vetëm.

**NENI 12  
VULA**

Shoqëria do të ketë vulën e saj.

**NENI 13  
ZGJIDHJA E MOSMARREVESHEVE**

Mosmarrëveshet që mund të lindin ndërmjet ortakëve ose ndërmjet ortakëve dhe shoqërisë dhe që ka lidhje me të drejta të disponoheshë në lidhje me marrëdhëni e tyre me shoqërime do t'i drejtohen per zgjidhje Gjykatës se Rrethit Gjyqesor Tirane.

*Aktin e themelimit e lexova dhe e gjeta konform vullnetit tim dhe e nënshkruaj pa vërejtje.*

**ORTAKJA E VETËM E SHOQËRISË  
ADMINISTRATORE**

**ZNJ. FRANCA FORIERI**

*Feri Forieri*